

VENDIM
Nr.848, datë 19.12.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË “UZINA MEKANIKE E NAFTËS” SHPK, KUÇOVË DHE
KRITERET BAZË PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTITORIT E PËR VLERËSIMIN E
OFERTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.9073, datë 29.5.2003 “Për privatizimin e shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” sh.p.k., Kuçovë” dhe të nenit 3 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për privatizimin e shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” sh.p.k., Kuçovë. Forma e privatizimit të jetë ajo e transferimit të të tretët e të drejtës së pronësisë të kuotave të kapitalit të saj.

2. Struktura e formulës së privatizimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë të jetë:

a) Jo më pak se 51 për qind e kuotave të kapitalit i ofrohen për transferim investitorit, nëpërmjet shitjes me tender të hapur. Pagesa e kësaj pakete kuotash të kapitalit të bëhet me para.

b) Ish-pronarëve të truallit u ofrohen kuotat e kapitalit, sipas vlerës së truallit të përfshirë në kapitalin e shoqërisë, siç përcaktohet në vendimin nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave dhe sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

c) Punonjësve të shoqërisë u ofrohen, proporcionalisht, kuotat e kapitalit të shoqërisë, në shkëmbim dhe në raport me vlerën e bonove të privatizimit, që u janë dhënë atyre nga shteti. Punonjës të uzinës mekanike të naftës sh.p.k, Kuçovë janë punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune që nga krijimi i shoqërisë deri në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9073, datë 29.5.2003, si dhe ata që kanë dalë në asistencë, me vendimin nr.422, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave.

3. Procedurat e tenderit të jenë sipas vendimit nr.529, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit të paketave të aksioneve, që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare”, me ndryshimet përkatëse.

4. Përzgjedhja e investitorit të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Vlerësimi i ofertave të investitorëve, që plotësojnë kriteret sipas shtojcës 1, të bëhet në mbështetje të kriterëve të mëposhtme:

a) Çmimi i ofruar 85 pikë.

b) Vlerat e investimit 10 pikë.

c) Plani i biznesit dhe cilësia e tij 5 pikë.

6. Punonjësit, që dalin të papunë nga procesi i privatizimit, të paguhen për 2 vjet me pagën bazë që kanë pasur në çastin e largimit nga puna. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit, pas transferimit të fondit financiar të të ardhurave nga privatizimi. Caktimi, administrimi dhe pagesa të bëhet nga zyrat përkatëse të punësimit.

7. Periudha 2-vjeçare t’u njihet punonjësve periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, nga Buxheti i Shtetit. Periudha e mësipërme shënohet në librezën e punës.

8. Të drejtën e përfitimit të pagesës sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës, të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike si punëdhënës, punëmarrës apo të vetëpunësuar, me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi. Në rast të kundërt, u ndërpritet pagesa që përfitojnë sipas këtij vendimi.

9. Kontributet e papaguara, së bashku me kamatëvonesat, që uzina mekanike e naftës, sh.p.k., Kuçovë ka ndaj sigurimeve shoqërore, të shlyhet brenda 30 ditëve nga arkëtimet, që do të realizohen nga privatizimi i shoqërisë.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORIT STRATEGJIKË TË INTERESUAR PËR
BLERJEN E PAKETËS SË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “UZINA MEKANIKE E
NAFTËS” SHPK, KUÇOVË

SHTOJCA 1

I. Midis investorëve që do të kenë dërguar shrehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 21.8.1998 “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti të shoqërive tregtare”, si dhe të përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investitorët e interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre të detyrueshme, duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme paraprahe:

a) Të jenë persona juridikë.

b) Të kenë një kapital, tërësisht të paguar, jo më pak se 3 milionë USD apo ekuivalentin e shumës, në valutën në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe sipas rastit, vlera neto e konsoliduar, duhet të jetë jo më pak se tre vjetët e fundit.

c) Të jenë shoqëri e specializuar në industrinë mekanike, ose konsorcium ku kontrollin e shoqërisë ta ketë shoqëria e specializuar në industrinë mekanike, e cila të ketë një aktivitet në industrinë mekanike jo më pak se tre vitet e fundit.

Të gjitha këto kërkesa do të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara zyrtare.

Palët, të cilat janë në likuidim ose nuk kanë aftësi paguese ose procedime të tjera të ngjashme ose ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese ose ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen.